



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:243685

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05717894

P.nr. 529/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykes Besnik Sheqiri, me procesmbajtës Izet Hyseni bashkëpunëtor profesional, në çështjen penale kundër të pandehurit S. A., për shkak të veprës penale “Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6604/23, të datës 09.11.2023, pas përfundimit të seancës së hapur të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 21.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Nazmi Krasniqi, të dëmtuarve P. dhe S. A. dhe të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

S. A., nga i ati N. dhe nëna L. e gjinisë Z., i lindur më ... , në fshatin Zh., Komuna P., ndërsa me vendbanim në Rr. “F.” në P., me nr. personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor fizik në ndërtimtari, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 29.09.2023, rreth orës 13:00, në fshatin Zh. të P., i pandehuri S. A., pas një mosmarrëveshje që kishte me të dëmtuarin P. A. në pronën e të cilit i kishte futur bagëtinë, dhe me të vërejtur i dëmtuari i cili kishte qenë me nënën e tij dhe ja kishte tërhequr vërejtjen duke i thënë: mos tento që të hysh në pronën time dhe mos i largo lopët derisa të vijnë policia, kurse i pandehuri ishte bërë agresiv e kishte marrë një shkop në dorë me të cilin kishte arritur ta godas në dorë të dëmtuarën S..

- me këtë ka kryer veprën penale “Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4 par. 1 nën-par. 1.4, 7, 17, 21, 69, 70, 81 dhe 82, si dhe neneve 364, 367, 449, 498 dhe 499 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

I. Me këtë vërejtje gjyqësore të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme penale dhe nëse i njëjti kryen prapë veprë të tillë, gjykata do t'i shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

II. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Të dëmtuarit P. dhe S. A., me adresë banimi në fshatin Zh., Komuna P., nuk kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.6604/23, të datës 09.11.2023, kundër të pandehurit S. A., për shkak të veprës penale "Sulmi" nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.05.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi është bindur se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtit i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e deklarimit të tij rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, shprehu keqardhje për veprimet e tij, me të dëmtuarit janë pajtuar me të cilët janë fqinjë, premtoi se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjashme, nga gjykata kërkoi që t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimin të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarve.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe si i tillë gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykatës i propozoi që pranimin e fajësisë ta aprovojë, të pandehurin ta shpall fajtor dhe dënojë sipas ligjit, po ashtu edhe të dëmtuarit P. dhe S. A. njëzëri u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri me të cilin janë pajtuar, deklaruan se nuk kërkojnë kompensim dëmi.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimin të fajësisë nga të pandehurit dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, të dëmtuarve, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës,

gjqytari i vetëm gjykues vërtetoi se në veprimet e të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe iu shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, është penduar dhe shprehu keqardhje për veprimet e tij, premtoi se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjashme, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj vlerësoi se sanksioni penal i shqiptuar të pandehurit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një sanksion të tillë penal do të arrihet qëllimi i vërejtjes gjyqësore i paraparë me nenin 81 të KPRK-së, i cili konsiston në të se kryesit i jepet qortimi dhe i’ bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbënë vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale/paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 81 dhe 82 të KPRK-së, si dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 529/23, datë 22.05.2024

Procesmbajtës
Izet Hyseni

Gjqytari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.